



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
— FERIZAJ —

Numri i protokolit: 4128/19

Datë: 15/11/2019

Për: **Z. Shyqiri BYTYQI, Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**

Nga: **Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI, Rektor i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF)**

Lënda: **NJOFTIM**

I nderuar z. Ministër Bytyqi,

Pa dashur të komentoj gjuhën që keni përdorur në një shkresë zyrtare (Referencë: 195/01B, datë: 14/11/2019) nga pozita e një Ministri të Arsimit, në adresë timen si rektor i UShAF, sinqerisht po ju sqaroj se prej se mbaj pozita të larta, qoftë si prodekan, dekan, prorektor, rektor, anëtar dhe kryesues i Këshillit Drejtues, por edhe si mësimdhënës, i kam respektuar me përpikmëri ligjet dhe aktet nënligjore.

Sa i përket përmbajtjes së shkresës, theksoj se nuk i kam kaluar asnjëherë kompetencat e mia dhe mbledhja të cilës ju i referoheni, ku është biseduar për CV-të respektivisht biografite dhe Planin Strategjik, është thirrë dhe udhëhequr nga Kryesuesi i Përkohshëm i Këshillit Drejtues (KD), derisa unë kam qenë prezent në cilësinë e rektorit ashtu siç parashihet me ligj.

Ua rikujtoj se Këshilli Drejtues nuk i përgjigjet Rektorit, por e kundërta. Prandaj, kërkesa për CV/biografite ka ardhur nga Kryesuesi i Përkohshëm dhe anëtarët e KD-së, duke qenë se të emëruarit tuaj nuk ishin persona të njohur për ta e as për publikun dhe biografite e të gjithë anëtarëve të KD-së, do të vendosen në ueb-faqen e institucionit.

Kjo kërkesë për biografine e tyre është legjitime dhe shumë e arsyeshme dhe nuk e kuptoj pse është fyer dikush rreth kësaj çështje, ashtu siç nuk e kuptoj çfarë të keqe ka përgatitja dhe prezantimi i strategjisë së anëtarëve të KD-së (të deleguar nga Ju) për të ardhmën e Universitetit, aq më shumë kur sipas Ligjit të Arsimit të Lartë, kryesues i KD-së së Universitetit zgjedhet nga radha e përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit!

Ne, jemi të obliguar që, për hirë të transparencës, t'i informojmë studentët dhe publikun për të arriturat akademike të personave vendimmarrës në Universitet.

Me respekt,

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI